



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.374/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Dardania Castle” Shpk, me pronar M.S., me seli në Vushtrri, kundër të paditurës Ministra e Kulturës Rinisë dhe Sportit me seli në Prishtinë, për shkak të mos nxjerrjes së aktit administrativ të miratuar në heshtje, jashtë seancës me datë 28.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa e paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.
- II. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “Dardania Castle” Shpk, me pronar M.S., me seli në Vushtrri, kundër të paditurës Ministra e Kulturës Rinisë dhe Sportit me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Dardania Castle” Shpk, me pronar M.S., me seli në Vushtrri, kundër të paditurës Ministra e Kulturës Rinisë dhe Sportit me seli në Prishtinë, për shkak të mos nxjerrjes së aktit administrativ të miratuar në heshtje.

Gjykata me datë 07.09.2020 paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’u paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr

konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Me datë 13.10.2020 pronari M.S. ka parashtruar kërkesa për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, me arsyetim se është invalid i luftës.

Konform Udhëzimin Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, nenit 8 shoqërit tregtarë nuk janë të liruara nga pagesa e taksës. Gjykata konstaton se padia është parashtruar në emër të Shoqërisë tregtare “Dardania Castle” Shpk, ndërsa probari është vetëm përfaqësues.

Prandaj pasi që paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.617/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.